



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58.pika „i“ të Ligjit mbi Qeverisjen Lokale Nr.03/L-040,,Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës“nr.28 të datës 4 Qershor 2008,nenit 30 të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe pergjegjesis si dhe nenit 40 pika,,h“të Statutit të Komunës së Lipjanit NR.110-78095 te dates 24.12.2021, Kryetari i Komunës së Lipjanit i propozon Kuvendit të Komunës:

Në mbështetje të neneve 12,16 dhe 17 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale NR.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 të datës 04.06.2008, si dhe nenit 9 paragrafi 9.1 te Ligji nr. 10/L-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 ,Statutit te Komunës së Lipjanit NR.110-78095 te dates 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë \_\_\_\_\_ 2026 miratoi këtë:

Propozim

#### VENDIM

PËR RITJEN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT NGA TEJKALIMI I TË HYRAVE VETANAKE PËR VITIN 2025

#### Neni 1.

Me këtë Propozim Vendim të bëhet rritja e planifikimit të buxhetit të të hyrave vetanake në shumë prej 737,770.18€ Kështu që vlera e të hyrave vetanake të planifikuara nga 3,174,047.00€ rritet në 3,911,817.18€.

#### Neni 2.

Mjetet nga Neni 1 i këti Vendimi planifikohen të destinohen si vijon:

#### Mallra e Sherbime:

Shërbimet e Shëndetësis Primare(730) Programi (73200).....	53,397.50€
Arsim dhe shkence(920) Programi-92250 .....	37,509.50€
Totali .....	90,907.00€

#### Shpenzime komunale:

Arsim dhe shkence(920) Programi-(92250).....	5,000.00€
Totali .....	5,000.00€

#### Shëndetsi dhe Mirëqenje Sociale(730)Programi –(73200)

53192 Ndertimi i qendres urgjente ne qytetin e Lipjanit.....	146,640.00€
Totali.....	146,640.00€

#### Shërbimet kulturore (850)-Programi (85003)

54338 Ndërtimi i Qendres multifunksionale në qytetin e Lipjanit .....	495,223.18€
Totali .....	495,223.18€

Totali i rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2025 në krahasim me planifikimin e buxhetit është 3,911,817.18€.

#### Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

### A r s y e t i m

Rritja e planifikimit të buxhetit bëhet për shkak të tejkalimit të planifikimit të të hyrave vetanake të vitit 2025. Kërkesa nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2025 nuk ka ndryshim në strukturën e shpenzimeve.

Rritja e të hyrave në kategorinë e mallra dhe shërbime në shumë prej 53,397.50€ në Shërbimet e shëndetësisë primare nga participimi i pacienteve bëhet për mbulimin e kërkesave të ndryshme (obligimet kontraktuale)

Rritja e të hyrave në kategorinë e mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale në shumë prej 42,509.50€ në Qerdhe nga participimi i prindërve bëhet për mbulimin e kërkesave të ndryshme (obligime kontraktuale)

- Projekti Ndërtimi i qendrës multifunksionale në qytetin e Lipjanit (54338) mbulohet nga rritja e të hyrave vetanake në shumë prej 641,863.18€. Projektit në fjalë ju kanë marrë mjetet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore me Ligj të Buxhetit 2026 shuma prej 800,000.00€.

Nr. 1-400/01-26921  
Lipjan: 16.06.2026

Kryetari i Komunës:  
Imri Ahmeti

